

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **KEK-26-2681-1-2-1** nr.brendshem **KEKC-26-199-1-2-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me pjesë ndërrimi për Eskavator Hidraulik teleskopik liebherr**

### ANKESË

#### 1. Identifikimi i ankuesit\*

**NSHT “AUTO SERVIS SISTEM”**

*(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)*

**Mazgit**

*(Adresa)*

**Obiliq**

*(Vendi)*

**+38344168690**

*(Numri Telefonit)*

**15000**

*(Kodi postar)*

**n/a**

*(Numri i Faks-it)*

**Ramadan Raqi**

*(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)*

**[autoservis-sistem@hotmail.com](mailto:autoservis-sistem@hotmail.com)**

*(Adresa elektronike)*

**25.06.2026**

*(Data e parashtrimit të ankesës)*



*(Nënshkrimi dhe vula)*



\*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

#### 2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- Njoftimi per kontrate 24.04.2026
- NJOFTIM PER VENDIMIN E AK 10.06.2026
- Hapja e ofertave 18.05.2026
- Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më të ulët

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

## 6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Me datën 15.06.2026 kompania e jone ka bërë Kërkesë për rishqyrtim pranë AK, ndërsa me datë 16.06.2026 kemi marrë përgjegjeje nga AK ku në mes tjerash shkruan në Vendim Refuzohet si e pabazuar kërkesa e paraqitur për rishqyrtim nga O.Ekonomik: Ramadan Raçi B.I. Mazgit, Obiliq, lidhur me aktivitetin e prokurimit: Furnizim me pjesë ndërrimi për Eskavator Hidraulik teleskopik liebherr, Nr. prok. KEKC-26-199-121(KEK-26-2681-1-2-1) me arsyetim se Stafit teknik i komisionit të vlerësimit rekomandon Zyrtarin Përgjegjës të Prokurimit që kërkesa për rishqyrtim e OE: Ramadan Raçi B.I. -Mazgit, Obiliq për tenderin: Furnizim me pjesë ndërrimi për Eskavator Hidraulik teleskopik liebherr, Nr. prok. KEKC-26-199-121(KEK-26-2681-1-2-1) të refuzohet dhe të procedohet aktiviteti i prokurimit me anulim të tenderit

## 7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

- Shkelja e nenit 1-Qëllimi i LPP-se të amendamentuar
- Shkelja e Nenit 6 – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti (LPP)
- Shkelja e nenin 7- Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi i LPP të amendamentuar
- Nenin 59 Ekz. Vler. dhe Krah. i Tendereve të LPP të amendamentuar,
- Shkelja e nenin 62- Dokumentacioni dhe informacioni shtesë i LPP-se

\*\* Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.

## 8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

*Shoqëria NSHT "AUTOSERVIS SISTEM" (me tej: Kerkuesi), brenda afatit ligjor te paraparë më dispozitën e Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 per Kerkesa , respektivisht, brenda afatit të lënë për Ankesa paraqet këtë:*

ANKESE

per shkak te:

*Konstatimit te gabuar te gjendjes faktike*

*Aplikimit te gabuar te te drejtes materiale*

Më të cilin Kerkese, Kerkuesi godet në tërësi Vendimin e AK , si akt administrativ të paqëndrueshëm, të ngutshëm, dhe absolutisht të pabazë dhe Propozon që

Kerkesen e paraqitur nga Kerkuesi ta miratoj si të bazuar në Ligj, Vendimin per Anulim te kesaj procedure ta Anuloj dhe AK te vazhdon me tutje me proceduren e prokurimit per projektin e lartepemendur.

*Duke shqyrtuar, analizuar proceduren e prokurimit mendojme qe AK nuk ka respektuar nenin 59 të LPP-se ,001/2022 RRPP, lidhur me vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve dhe njëherit edhe konsiderohet shkelje te LPP-se.*

**I. Objekti i ankesës.-**Kjo ankesë paraqitet kundër:

1. Vendimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit; dhe
2. Vendimit për refuzimin si të pabazuar të kërkesës për rishqyrtim,

me të cilat janë shkelur dispozitat thelbësore të Ligjit për Prokurimin Publik, veçanërisht **Neni 59 dhe Neni 62**, si dhe parimet bazë të transparencës, trajtimit të barabartë dhe ekonomikitetit.

**II. Shkelja e Nenit 59 – Vlerësimi i tenderëve.-**Autoriteti Kontraktues ka dështuar në zbatimin korrekt të Nenit 59 të LPP, pasi:

**1. Ka ndryshuar interpretimin e specifikimeve pas hapjes së ofertave**

AK në fazën e vlerësimit dhe më pas në refuzim:

- ka futur interpretim të ri teknik për “zëvendësim kodi” (10123638 me 10137930),
- pa asnjë bazë në Dosjen e Tenderit,
- pa asnjë sqarim paraprak gjatë procedurës së tenderimit.

**2. Ka bërë vlerësim jo objektiv të përputhshmërisë teknike**

Në vend të vlerësimit sipas DT, AK:

- ka ndryshuar në mënyrë retroaktive kuptimin e specifikimit teknik;
- ka përdorur dokumente të jashtme (katalogë/prodhues) që nuk janë pjesë detyruese e DT.

Kjo përbën devijim nga vlerësimi i ligjshëm sipas Nenit 59 dhe prish barazinë e ofertuesve.

**III. Shkelja e Nenit 62 – Anulimi i aktivitetit.**-Anulimi i aktivitetit është bërë në mënyrë të pabazuar dhe në kundërshtim me Nenit 62, sepse:

**1. Nuk ekziston “shuarje e nevojës”**

AK ka arsyetuar se nevoja është shuar për shkak të kontratës kornizë.

Mirëpo:

- **Kodi 10123638 – Pompa Hidraulike Variable nuk është pjesë e kontratës kornizë**
- pajisja kryesore mbetet e pa mbuluar funksionalisht;
- nevoja reale teknike ekziston dhe është e dokumentueshme.

Pra, baza ligjore për anulim nuk ekziston faktikisht.

**2. Anulimi është përdorur si mekanizëm pas vlerësimit**

Nga kronologjia:

- procedura është hapur,
- ofertat janë pranuar,
- është identifikuar ofertë e përgjegjshme dhe ekonomikisht e favorshme,
- pastaj është anuluar procedura.

Kjo krijon dyshim të arsyeshëm për **anulim jo objektiv dhe jo në frymën e Nenit 62.**

**3. Mungesë e analizës ekonomike (shkelje substanciale)**

AK nuk ka paraqitur:

- asnjë analizë krahasuese të kostos;
- asnjë justifikim financiar për heqjen dorë nga procedura;

përkundër faktit se ekziston ofertë **dukshëm më e favorshme financiarisht (~10,000 € diferencë).**

Kjo bie drejtpërdrejt ndesh me parimin e **përdorimit efikas të fondeve publike.**

**IV. Kundërshtimi i arsytimit të refuzimit të AK.**-Pretendimi i AK se:- Kodi 10123638 zëvendësohet me kodin 10137930

është:

- i pa parashikuar në Dosjen e Tenderit;
- i pa shoqëruar me amendament zyrtar;
- i pa bërë pjesë e kushteve të detyrueshme të DT.

1209	928337508	DRITË	HEADLIGHT RIGHT	copë	1	1
1210	12237522	BULON	HEX SCREW	copë	1	3
1211	10037619	FILTER	FILTER INSERT	copë	1	1
1212	10137930	POMPË HIDRAULIKE	HYDR. VARIABLE DISPLACEMENT PUMP	copë	1	2
1213	10137949	TERMOSTAT	THERMOSTAT	copë	1	1
1214	12238204	SET SEMERINGASH	SEAL KIT	copë	1	3

Në Aneksin 1, të dy kodet figurojnë si artikuj të veçantë teknikë, pa asnjë shënim zëvendësimi. Prandaj, ky interpretim përbën **ndryshim të njëanshëm të kushteve të tenderit pas hapjes së ofertave**, që është i ndaluar.

**IV.1. Interpretim teknik i pabazuar dhe jo-konform katalogut të prodhuesit.**-Autoriteti Kontraktues në refuzimin e kërkesës për rishqyrtim ka pretenduar se kodi **10123638** zëvendësohet me kodin **10137930**, duke e trajtuar këtë të fundit si ekuivalent teknik.

Ky interpretim është i pasaktë dhe nuk mbështetet në dokumentacionin teknik të prodhuesit, për arsyet si vijon:

Sipas katalogut zyrtar të prodhuesit, kodi **10123638** është i aplikueshëm për makineritë me numra serialë **0000047053 – 0000065765**, ndërsa kodi **10137930** është i aplikueshëm vetëm për makineritë me numra serialë **0000065766 e tutje**.

Kjo ndarje e qartë nga prodhuesi dëshmon se:

- nuk kemi të bëjmë me ekuivalencë teknike të lirë, por me **ndarje të qartë sipas konfigurimeve dhe intervaleve të ndryshme të pajisjeve**;
- kodi **10137930** nuk është zëvendësim universal i kodit **10123638**, por pjesë e një konfigurimi tjetër teknik të pajisjes.

Për më tepër, sipas dokumentacionit teknik, kodi i ri përmban **ndryshime në komponentët e brendshëm**, të cilat ndikojnë në karakteristikat funksionale dhe performancën e sistemit hidraulik, duke e bërë të pamundur trajtimin e tij si pjesë identike ose ekuivalente pa analizë të detajuar teknike dhe pa ndryshim zyrtar të specifikimit në Dosjen e Tenderit.

**IV.2. Mospërputhja me Specifikimin Teknik të DT.**-Aneksi 1 i Dosjes së Tenderit ka kërkuar në mënyrë eksplicite kodin **10123638**, dhe nuk përmban asnjë:

- klauzolë zëvendësimi,
- referencë ekuivalence,
- apo shënim teknik që lejon interpretim alternativ.

Prandaj:

- ofertuesi ka ofruar saktësisht kodin e kërkuar;
- çdo interpretim pasues i AK për ndryshim kodi përbën **ndryshim ex post të kushteve të tenderit**, gjë e ndaluar nga parimet e prokurimit publik.

**IV.3. Përfundim i këtij argumenti.-** Si rrjedhë, pretendimi i AK se kodi i ofruar “zëvendësohet” me një kod tjetër:

- është teknikisht i pabazuar,
- juridikisht i paqëndrueshëm,
- dhe nuk mund të përdoret si arsye për refuzim apo anulim të procedurës.

**V. Shkelja e parimeve themelore të LPP.-**Me këto veprime janë shkelur drejtpërdrejt:

- Parimi i transparencës
- Parimi i trajtimit të barabartë
- Parimi i konkurrencës së drejtë
- Parimi i ekonomicitetit dhe efikasitetit të fondeve publike

**VI. Përfundim.-**Vendimi i Autoritetit Kontraktues është:

- i pambështetur në dispozitat e Nenit 59 dhe 62;
- i bazuar në interpretim të pasaktë dhe jo të parashikuar në DT;
- dhe në kundërshtim me parimet themelore të prokurimit publik.

**VII. Kërkesë.-**Kërkojmë nga OSHP që:

1. Të aprovojë ankesën si të bazuar;
2. Të anulojë vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim;
3. Të anulojë vendimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit;
4. Të detyrojë AK të vazhdojë procedurën nga faza e vlerësimit të ofertave;
5. Subsidiarisht, të konstatojë shkelje të Nenit 59 dhe 62 nga AK.

## 9. Dëmet materiale

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

*Dëmet materiale që na shkaktohen nëse ne nuk e marrim këtë kontratë janë të konsiderueshme si në fushën financiare, fitime të munguara, dhe mos mundësi e kompensimit të shpenzimeve përgatitore për këtë kontratë. Po ashtu kemi edhe dëmtim të reputacionit si një kompani shumë serioze, me një përvojë shume te gjate në këtë fushë  
Demi material konsiderohet te jete 5000 euro.*

## 10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*

- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

*\*\*\*Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*